

32.214

REPUBLIKA E SHQIPERISE
GJYKATA E SHKALLES SE PARE TIRANE
NR. 322/4 Vendimi

V E N D I M
PER REGJISTRIMIN SI PERSON JURIDIK

Ne Tirane, sot me date 30 09.2004, une, gjyqtarja e Gjykates se Shkalles se Pare Tirane B. Lushaj, pasi mora ne shqyrtim kerkesen dhe aktet e tjera te paraqitura nga Astrit Hoxha, administrator I shoqerise "STAR" shpk dhe

K O N S T A T O V A S E :

Se kerkuesi Astrit Hoxha me cilesine e administratorit, I eshte drejtuar Gjykates se Shkalles se pare Tirane, me kerkese per regjistrimin si person juridik te shoqerise

" STAR " shpk. Sipas aktit te themelimit dhe statutit te nenshkruar nga ortaket Astrit Hoxha dhe Taulant Ismaili eshte themeluar shoqeria me pergjegjesi te kufizuar " STAR " shpk, me :

Seli ne Fier, Lagja Apollonia, Sheshi Fitorja.

Kohezgjatje te veprimtarise te pakufizuar.

Administrator Astrit Hoxha.

Kapital 100.000 leke.

Ortake Astrit Hoxha zoterues I 50 % te kapitalit me vlere 50.000 leke dhe

Taulant Ismaili zoterues I 50 % te kapitalit me vlere 50.000 leke.

Objekt te veprimtarise ne fushen e transmetimit radio - televiziv lokale. Prodhim transmetim dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuar per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, sateliteve apo me cdo mjet tjetër.

Kerkesa eshte e drejte dhe si e tille duhet pranuar.

P E R K E T O A R E S Y E :

Ne baze te ligjit nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" dhe atij nr.7667, date 28.01.1993 "Per regjistrin tregetar"

V E N D O S A

Pranimin e kerkeses.

Regjistrimin si person juridik te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin " STAR " shpk, me :

Seli ne Fier, Lagja Apollonia, Sheshi Fitorja.

Kohezgjatje te veprimtarise te pakufizuar.

Administrator Astrit Hoxha.


Kapital 100.000 leke.

Ortake Astrit Hoxha zoterues I 50 % te kapitalit me vlere 50.000 leke dhe

Taulant Ismaili zoterues I 50 % te kapitalit me vlere 50.000 leke.

Objekt te veprimtarise ne fushen e transmetimit radio - televiziv lokale. Prodhim transmetim dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve te cdo lloji me ane te zerit, figures, sinjaleve te koduara, shkrimit te destinuar per publikun nepermjet valeve elektromagnetike, kablllove, sateliteve apo me cdo mjet tjetër.

GJYQTARE,



AKT - THEMELIMI I SHOQËRISË

"STAR" SH.P.K

Sot më datë 05 shtator 2004 ne të nënshkruarit Astrit Hoxha, Taulant Ismaili, me dëshirën dhe vullnetin tonë të plotë, në mbështetje të Ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" dhe nr. 7667 datë 28.01.1993 "Për regjistrimin në regjistrin tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregëtare" vendosëm që të formulojmë këtë akt për themelimin e një shoqërie tregëtare private me përgjegjësi të kufizuar sh.p.k si më poshtë vijon:

Neni 1.

Të formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar me emërtimin "S T A R " sh.p.k.

Neni 2.

Shoqëria do të ketë qendrën e vet në L. Apollonia, Sheshi Fitorja, Fier dhe mund të hapë sipas rastit edhe degë të tjera në qytete të tjera.

Neni 3.

Shoqëria krijohet për një aktivitet me kohëzgjatje të pakufizuar. Ky afat mund të zgjatet por edhe mund të shkurtohet për rastet kur shoqëria do të shpërbëhet sipas përcaktimeve që do të paszyrohen në statut.

Neni 4.


Themelues të shoqërisë janë zoti Astrit Hoxha, zoti Taulant Ismaili, të cilët janë ortakët e saj dhe administrator i shoqërisë është zoti Astrit Hoxha.


Neni 5.

Shoqëria tregtare private "STAR" sh.p.k ka për object të veprimtarisë së saj:

- Transmetimin Radio-Televizive *lokali*
- Prodhimin, transmetimin

dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit të





destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kabllorë, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.

Neni 6.

Për fillimin e aktivitetit të kësaj shoqërie themeluesit e saj kanë vënë një kapital fillestar prej 100.000 lekësh, nga 50% secili, shumë e cila është pronë vetjake e themeluesve si ortakë.

Neni 7.

Fitimi i shoqërisë iu përket tërësisht ortakëve të shoqërisë, zotërinjve Astrit Hoxha, Taulant Ismaili. Ky fitim do të disponohet lirisht prej tyre në bazë të raportit të kontributit të tyre në kapitalin themeltar, pasi të jenë shlyer më parë detyrimet tatuese fiskale dhe ato ndaj të tretëve.

Neni 8.

Organ vendimor në shoqëri është Asambleja e ortakëve, e cila thirret në seancë të zakonshme të paktën një herë në vit dhe drejtohet nga Administratori i shoqërisë. Kjo asamble merr vendime të zakonshme ose të jashtëzakonshme sipas disponimeve të statutit të shoqërisë.

Neni 9.

Do të konsiderohen si veprimtari e shoqërisë vetëm ato veprime juridiko-civile që do të kryhen nga organet ose punonjësit e saj, konform disponimeve në statutin e saj dhe në mbështetje të legjislacionit në fuqi.

Neni 10.

Si rregull, veprimet ekonomike të shoqërisë do të mbyllen më 31 dhjetor të cdo viti. Përfundim nga ky rregull do të bëhet kur e kërkon organi kompetent ligjor.

Neni 11.

Shoqëria do të shpërbëhet sipas rasteve që do të përcaktohen në statutin e saj.

Neni 12.


Mosmarrëveshjet që mund të lindin midis personave pjesëmarrës ose jo në shoqëri, do të zgjidhen me mirëkuptim midis tyre. Në rast se kjo nuk arrihet, ato do të zgjidhen nga Gjykata kompetente sipas legjislacionit shqiptar.

Neni 13.


Ky akt themelimi përpilohet në 4 kopje të barabarta në gjuhën shqipe, njëra prej të cilave do të ruhet në dokumentacionin bazë të shoqërisë tregëtare "STAR" sh.p.k

ORTAKËT E SHOQËRISË

Astrit Hoxha

Astrit Hoxha


Taulant Ismaili

Taulant Ismaili




STATUTI

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI

TË KUFIZUAR

“STAR”

FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA.

Neni 1.

Shoqëria formohet nga themeluesit:

- Astrit Hoxha, i biri i Neimit, dtl. 1963, lindur në Berat, banues në Fier, pasaportë Z0025648.
- Taulant Ismaili, i biri i Azizit, dtl. 1973, lindur e banes në Fier, pasaportë Z0025282.

Neni 2.

Shoqëria është person juridik dhe është krijuar në përputhje e Legjislacionin Shqiptar dhe si e tillë e fillon aktivitetin me regjistrimin e saj në regjistrin tregtar të Gjykatës së Rrethit Tiranë.

Neni 3.

Selia e shoqërisë është në L. Apollonia, Sheshi “Fitorja”, Fier. Shoqëria mund ta ndryshojë selinë e saj me zgjerimin e aktivitetit dhe miratimin e ortakëve.

Neni 4.

Shoqëria e zhvillon aktivitetin në përputhje me Statutin e saj dhe Legjislacionin shqiptar, në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij.

Shoqëria mund të krijojë filiale në vende të tjera në përputhje me legjislacionin përkatës të atij vendi.



LIBRI I SHOQËRISË

Neni 5.

Për të precizuar dhe saktësuar veprimtarinë e vet ekonomike dhe marrëdhëniet e punës, shoqëria do të nxjerrë librin e vet, i cili do të quhet

LIBRI I SHOQËRISË.

Neni 6.

Të gjitha aktet dhe dokumentet e tjera që do të nxirren nga shoqëria të destinuara për të tretët si letrat, faturat, lajmërimet dhe publikimet e ndryshme, duhet të tregojnë lexueshëm emrin e shoqërisë dhe pas tij fjalët "Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar" ose inicialet sh.p.k dhe emrin e administratorit.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 8.


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohe të pakufizuar nga data e regjistrimit në regjistrin themeltar.


OBJEKTI I VEPRIMTARISË

Neni 9.

- Transmetimin Radio-Televizive
- Prodhimin, transmetimin

dhe ritransmetimin e programeve dhe informacioneve të çdo lloji me anë të zërit, figurës, sinjaleve të koduara, shkrimit të destinuara për publikun nëpërmjet valëve elektromagnetike, kablove, satelitëve apo me çdo mjet tjetër.






KAPITALI THEMELTAR

Neni 10.

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë i ndarë me nga 50% për secilin ortak.

Ky kapital është shlyer plotësisht dhe nënshkruar nga ortakët.

Shoqëria mund të shtojë apo pakësojë kapitalet e saj me miratimin e ortakëve themelues.



Neni 11.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.

Gjithastu pjesët e kapitalit themeltar mund t'iu transferohen edhe të tretëve me miratimin e ortakëve. Po kështu, ato janë lirisht të transferueshme në rast ndarjes paurore mes bashkëshortëve si edhe në rrugë trashëgimie. Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohen me një akt noterial.

STRUKTURA JURIDIKE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 12.

Shoqëria do të konsiderojë si qendër të saj atë në L. Apollonia, Sheshi "Fitorja", Fier, Shqipëri. Ajo mund të hapë sipas rastit studio dhe degë të tjera në qytete të tjera të vendit.

Neni 13.

Organi më i lartë i drejtimit të shoqërisë është Asambleja e Ortakëve. Shoqëria administrohet nga administratori, i caktuar në Mbledhjen e parë të ortakëve, zoti Astrit Hoxha.

ASAMBLEJA

Neni 14.

Thirrjet e Asamblesë bëhen me letra që përmbajnë rendin e ditës, vendin dhe orën e mbledhjes dëguar secilit ortak së paku 10 ditë përpara, ose, në raste

urgjente, së paku 2 ditë para, me telegram. Administratori duhet të njoftojë gjithashtu Asamblenë brenda 5 ditëve kur ka marrë kërkesë nga ortakët ose nga njëri prej tyre, që përfaqëson së paku 10% të kapitalit të shoqërisë dhe në këto kërkesa tregohen çështjet që duhen trajtuar.

Asambleja drejtohet nga Administratori i shoqërisë nëqoftëse ajo nuk vendos ndryshe. Administratori emëron një sekretar për të mbajtur process verbalin. Secili ortak mund të përfaqësohet edhe me një prokurë të posaçme me shkrim nga një person që nuk është ortak.

Neni 16.

Asambleja merr këto vendime të zakonshme:

- miraton statutin e shoqërisë dhe rregulloren e brendshme të saj
- zgjedh administratorin e shoqërisë
- vendos dhe analizon veprimtarinë ekonomike dhe financiare të shoqërisë
- bën pranimin e anëtarëve të rinj të shoqërisë.

Neni 17.

Asambleja merr vendime të jashtëzakonshme si:

- ndryshimin e statutit të shoqërisë dhe aktit të krijimit
- emerimin e personave të ngarkuar për likuidim.

Neni 18.

Asambleja e zakonshme dhe e jashtëzakonshme krijohet në rastin e parë të takimit me prezencën e ortakëve, të cilët, vendosin në mënyrë të vlefshme, me vota pro, me aq ortakë sa të përfaqësohet shumica absolute e kapitalit themeltar.





LIBRI E SHOQËRISË, BILANCI, SHPËRNDARJA DHE

LIKUIDIMI

Neni 19.

Shoqëria është e detyruar të mbajë, përveç dokumentacionit kontabël ose librave të tjerë edhe këto libra:

1. Libri i ortakëve, në të cilin shënohet emri i plotë i tyre dhe kuota e kapitalit themeltar.
2. Libri i Mbledhjeve dhe vendimeve të organit vendimor.
3. Libri i Mbledhjeve dhe vendimeve të organit administativ.

ADMINISTRIMI

Neni 20.

Administratori ka kompetenca për të vepruar në marrëdhëniet me të tretët në emër të shoqërisë në të gjitha rrethanat.

Administratori ka të drejtë të marrë pjesë në shitblerje, procedura falimentimi, të tjetërsojë pasuri të tundshme dhe të patundshme, të hapë llogari rrjedhëse pranë bankave shqiptare dhe të huaja, të përfaqësojë shoqërinë në organet gjyqësore dhe ato administrative.

I pajisur me prokurë të posaçme nga Asambleja, administratori mund të kapërcejë dhe të veprojë edhe përtej kufizimeve të sipërpërmendura në këtë nen. Administratori merr të gjitha vendimet që janë në interes të punës dhe prodhimit për problemet e emergjencës

Raporton dhe përgjigjet para Asamblesë për drejtimin e shoqërisë.

Vendos për marrjen në punë dhe largimin apo pushimin nga puna të personave që ai ka në varësi administrative.

Administratori është unik. Ai mund të jetë njëri nga ortakët ose një person tjetër.

Neni 21.

Administratori zgjidhet nga asambleja e ortakëve për një afat dy vjeçar. Me mirëkuptimin e ortakëve ai mund të qëndrojë i tillë edhe përtej këtij afati me kusht shqyrtimin formal të kandidaturës së tij menjëherë pas mbarimit të

mandatit dyvjeçar. Kandidatura nuk është e përsëritshme kur të paktën 40% e kapitalit themeltar e përfaqësuar nga një a më shumë ortakë nuk e mbështesin atë.

Administratori e pushon veprimtarinë e tij kur:

- Jep dorëheqjen
- Përfundon afati
- Shkel rëndë e në mënyrë të përsëritur statutin, aktin e themelimit, dhe ligjet e shtetit shqiptar.

ANËTARËSIA (Të qënit ortak)

Neni 22.

Anëtar i shoqërisë quhet ai person i cili merr pjesë në kapitali themelor të shoqërisë me të drejtën e tij të pronësisë mbi pjesët e tij të njohura ligjërisht me aktet ligjore, konform legjislacionit shqiptar.

Anëtarësia në përgjithësi është e drejtë vetjake.

Kuotat e anëtarit mund të transferohen me aktet ndërmjet të gjallëve nga ortaku tek bashkëshorti dhe farefisi. Ato mund t'ju tranferohen edhe të tjerëve. Gjithmonë në këto raste kërkohet miratimi i Asamblesë së ortakëve. Anëtari i shoqërisë nuk mund të jetë s ii tillë në më shumë se një shoqëri me këtë object veprimtarie.

Neni 23.

Të drejtat e anëtarit humbasi kur:

- Anëtari largohet nga shoqëria me dëshirën e vet
- Zhvillon aktivitet të jashtëm ekonomik që bie ndesh dhe dëmton rëndë interesat e shoqërisë apo i krijon asaj për përfitim personal situata rënduese konkurrese.

Neni 24.

Çdo anëtar ka të drejtë:

- Të zgjedhë dhe të zgjidhë në organet e shoqërisë.
- Të marrë pjesë në veprimtarinë prodhuese dhe shoqërore të shoqërisë.
- Të gëzojë të ardhurat (fitimin) që rrjedh nga ktiviteti i shoqërisë.



BILANCI

Neni 25.

Bilanci mbyllet në 31 dhjetor të cdo viti. I pari do të jetë ai i vitit 2004.

Llogaritë vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e hartuara nga eksperti kontabël i autorizuar nga ortakët, miraohet nga ata. Miratimi i këtyre dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 4 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 26.

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar i përballon humbjet e saj deri në kufirin e vlerës së kapitalit të investuar në të.

DIVIDENTËT

Neni 27.


Pas miratimit të llogarive vjetore dhe të evidentimit të ekzistencës së fitimit, përcaktohet pjesa që iu takon ortakëve themelues në formën e dividendit mbi fitimin.

Ky fitim përbëhet nga: fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjane për fodnin e lënë rezervë të domodoshëm, të përcaktuar nga ortakët, të fondeve të tjera që shihen të nevojshem dhe nga ana tjetër janë zbritur ose janë shtuar respektivisht humbjet apo fitimet e mbartura nga vitet e mëparshme.

SHPËRNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQËRISË

Neni 28.

Shoqëria priset kur ka një prishje të parakohshme të parashikuar me ligj ose me vendim të Asamblesë.



Neni 29.

Shoqëria hyn në procesin e likuidimit që në momentin e prishjes së saj. Për kryerjen e këtij procesi ortakët caktojnë një ose disa likuidues, të cilët i paraqesin Asamblesë raportin mbi gjendjen e aktivitetit dhe pasivitetit të shoqërisë, mbi ndjekjen e operacioneve të likuidimit dhe mbi afatet e nevojshme të përfundimit të tyre. Në fund të procesit të likuidimit ortakët vendosin mbi bilancin përfundimtar financiar dhe mbi mbylljen e procesit të likuidimit. Pas pagimit të kreditorëve dhe shlyerjes së kapitalit themeltar kontribues (përveç të tjerëve) likuiduesi ndaj kapitalet për ortakët themelues.

MARRËDHËNIET PËR PUNËSIM

Neni 30.

Kriteret e përgjithshme të punësimit të personave të tjerë, numri i tyre, kufitë e pagesës dhe detyrat e secilit në shoqëri, përcaktohen nga ortakët. Punësimi i personave në shoqëri kryhet mbi bazën e kontratës individuale të punës të hartuar sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.


Neni 31.

Shoqëria merr përsipër të respektojë rregullat në fuqi të punësimit dhe të sigurimeve shoqërore për të gjithë të punësuarit, ndërsa këta të fundit duhet të pranojnë këtë statut.

Të punësuarit përgjigjen sipas ligjit dhe sipas këtij statuti për moszbatimin e detyrave dhe për dëmet që ata i shkaktojnë shoqërisë.

Neni 32.

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin gjatë ekzistencës së shoqërisë ose gjatë periudhës së likuidimit, ose midis shoqërisë dhe të tretëve, do të tentohen të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do t'i paraqiten për zgjidhje gjykatës kompetente shqiptare konform legjislacionit.



DISPOZITA E FUNDIT

Neni 33.

Shtimi i ortakëve.

Kur ortakët janë dakord që të bëhen shtesa kapitali me anë të personave të tjerë, që këta të konsiderohen ortakë, duhet të veprohet kështu:



Së pari: merret vendimi nga ortakët themelues, ku shqyrtohet kërkesa e të interesuarit, bëhet pranimi dhe përcaktohet kuota e kapitalit që do të derdhë ortaku i ardhshëm.

Së dyti: bëhet regjistrimi në librin e ortakut, ku shkruhet emri i plotë i ortakut të ri dhe kuota në kapitalin e shoqërisë.

Veprimi i bashkimit me ortakun e ri duhet të bëhet me një akt noterial.

Neni 34.

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet plotësimit të mëtejshëm me anë amenamentesh sa herë që e shohin të arësyeshme ortakët themelues të kësaj shoqërie. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij statuti bëhen në të njëjtën mënyrë dhe procedurë me të cilën bëhet vetë nxjerrja e këtij statuti. Ndryshimet nuk prekin personalitetin juridik të shoqërisë.

Ky statut është hartuar në 4 kopje shqip, nga të cilat njëra depozitohet në Gjykatën e Tiranës dhe pasi u lexua e gjendet në përputhje me vullnetin e palëve nënshkruhet rregullisht prej tyre.

ORTAKËT THEMELUES

Astrit Hoxha

Taulant Ismaili

Astrit Hoxha

Taulant Ismaili

[Signature]

[Signature]

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE FIER
NOTERE PUBLIKE Ilda Sharra
NR 33 REP



VERTETIM DEPOZITIMI

Sot me dt. 28.09.2004 u paraqite shtetasi Astrit Hoxha i dtlindjes 1963 lindur ne banues ne-Fier me cilesin e Ortakut dhe administratorit te shoqerise "STAR " shpk ,shoqeri ne krijim i cili eshte i njohur personalishte prej meje noteres .

Depozituesi i sipershenuar , me cilesin e administratorit te shoqeris"STAR " depozitoi prane meje noteres shumen 100.000 mije leke(njeqind mije leke te reja),per garanci dhe si kushte per krijimin dhe rregjistrimin e shoqerise "STAR " "Sh.p.k.ne gjykatën e rrethit Tirane.depozitimi do te behet sipas ligjit per noterine prane zyres se noterise ne regjistrin e depozitimit te parave ose vlerave monetare .

Kjo shume do te qendroje e depozituar prane meje noteres deri sa i interesuari te me paraqes vendimin e rregjistrimit ne gjykatën e rrethit Tirane ku shpk "STAR " te jete regjistruar si person juridik.

Une noterja vertetoje aktin e depozitimit .

NOTERE
ILDA SHARRA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË FIER
Nr. 1665... Regj

Fier më 28/09/04

V È R T E T I M

Vërtetoj se para meje noteres u paraqitën shtetasit Astrit Hoxha, dtl. 17.01.1963, lindur në Berat, banues në Fier dhe Taulant Ismaili, dt.01.12 1973, lindur dhe banues në Fier, madhorë, me zotësi të plotë veprimtari juridik, të cilët e nënshkruan aktin në praninë time.

NOTERIE
NOTERE
ILDA SHARRA

NOTERIE
NOTERE
FIER


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E NOTERISË FIER
Nr. 1664..... Regj



Fier më 28/09/2004

V Ë R T E T I M

Vërtetoj se para meje noteres u paraqitën shtetasit Astrit Hoxha, dtl. 17.01.1963, lindur në Berat, banues në Fier dhe Taulant Ismaili, dt.01.12 1973, lindur dhe banues në Fier, madhorë, me zotësi të plotë veprimit juridik, të cilët e nënshkruan aktin në praninë time.



NOTERE
NOTËRE
ILDA SHARRA

PULLE TAKSE

100 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE

100 LEKE R.SHQIPERISE

PULLE TAKSE

32214

3 B Mucës
SHQIPËRIE
REGJISTROR 2004
Stran

KERKESE

Kërkues: ASTRIT HOXHA, lindur më 1963 ne FIER e po aty banuesme cilesin e Administratorit dhe ortakut te vetem te shoqeris "STAR" Sh.p.k.

OBJEKTI: Kërkoj regjistrimin e shoqërisë tregëtare "STAR" sh.p.k. si person juridik në regjistrin tregëtar në bazë të Ligjit 7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" dhe nr. 7667 datë 28.01.1993 për "Regjistrimin në regjistrin tregëtar dhe formalitetet që duhen respektuar nga shoqëritë tregëtare"

GJYKATES SE RRETHIT TIRANE

Unë kërkuesi jam ortak dhe administrator i shoqërisë tregëtare përgjegjësi të kufizuar "STAR" sh.p.k. Duke respektuar kërkesat e ligjit për shoqëritë tregëtare kerkoje regjistrimin si person juridik te shoqerise tregtare "STAR" me seli ne qytetin e Fierit me kapital thjemeltare 100.000 leke prone E ORTAKEVE Astrit Hoxha dhe Taulant Ismaili me përqindje ne kapitalin Themeltare 50% sejcili ortak dhe me objekt te shoqerise sipas pikave te shenuara ne akt themelimi dhe ne Statutin e shoqerise. Në këto kushte kërkoje të pranohet kërkesa ime duke u regjistruar kjo shoqëri si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në regjistrin tregëtar. Bashkangjitur paraqes dokumentat përkatëse

KERKUESI

Gi regji dt 30

*Vitetu m depoh
Nr 33 dt. 28.9.04
Akt Hoxha
30.9.04
Beteuta
Pfi IN
dt. 28.9.*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
ZYRA E NOTERISE FIER
Nr. ...Regj

Fier me 28/09/2004.

VERTETIM

Vërtetoj se para meje noteres u paraqit shtetesja Astrit Hoxha, lindur në 1963 e banues ne Fier, madhor, me zotësi të plotë veprimi juridiki Me shtetesesi dhe kombesi Shqiptare identifikuar me pashaporten e saj, e cila e nëshkroi aktin në praninë time.

